



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë
Ministarstvo za inovacije i preduzetništvo - Ministry of Innovation and Entrepreneurship

Nr. 57/2018

Datë: 20/08/2018

Në mbështetje të nenit 38 të Ligjit Nr.03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, Nr. 82, 21 tetor 2010), nenin 17 (paragrafi 5 dhe 6) të Rregullores Nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011), Rregullores së MF - Nr - 04/2017, për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OJQ-të si dhe Rekomandimit me nr.484 të datës 16.08.2018, të Komisionit për Vlerësimin e Projekteve/Aplikacioneve, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, nxjerr:


VENDIM

**PËR ANULIMIN E THIRRJES PUBLIKE PËR MBËSHTETJE FINANCIARE PËR PROJEKTET
E OJQ-VE NË PROMOVIMIN DHE MBËSHTETJEN E INOVACIONIT DHE
NDËRMARRËSISË**

1. **ANULOHE**T Thirrja Publike për "MBËSHTETJE FINANCIARE PËR PROJEKTET E OJQ-VE NË PROMOVIMIN DHE MBËSHTETJEN E INOVACIONIT DHE NDËRMARRËSISË", e shpallur me dt. 17.05.2018, nga Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë.
2. **OBLIGOHE**T Komisioni i MIN për hartimin e dokumentacionit dhe kushteve të përcaktuara me Rregulloren e MF - Nr - 04/2017, për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OJQ-të, të përgatisë dokumentacionin për të bërë rishpalljen e thirrjes publike për mbështetjen financiare për OJQ-të.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Me këtë vendim **anulohet** Thirrja Publike "Mbështetja Financiare për Projektet e OJQ-ve në Promovimin dhe Mbështetjen e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë" e shpallur me dt. 17.05.2018, nga Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, duke u bazuar në Rekomandimin me nr.484 të datës 16.08.2018, të Komisionit për Vlerësimin e Projekteve/Aplikacioneve.



Mentor Sylmeta

U.E. Sekretar / Përgjithshëm

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm
- Anëtarëve të Komisionit;
- Arkivit të MIN.